



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 164/ Prot.

Gjirokastër, më 11.02.2021

V E N D I M

Nr. 06, datë 11.02.2021

**MIRATIMI I KRITEREVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË
"BACHELOR " DHE CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE " PËR VITIN
AKADEMIK 2022 - 2023**

DHE

**MIRATIMI I KUOTAVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT NË TË TRE CIKLET E
STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe pika 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 83 pika 1/b , neni 135 , nenit 14 të Statutit të Universitetit " Eqrem Çabej " si dhe vendimeve të Dekanëve të Njësive Kryesore me nr Vendimi 01 date 29.01.2021, të FESHSH-së, nr 01, datë 29.01.2021 të FSHN-së dhe nr. 01 prot, datë 09 .02. 2021 të FE-së, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej , në mbledhjen e tij të datës, 11. 02. 2021, :

V E N D O S I :

1. Të miratojë kriteret e pranimi për studentët në programet e ciklit të parë "Bachelor", për vitin akademik 2022 – 2023, si mëposhtë:
 - a. Nota mesatare e përgjithshme arithmetike e shkollës së mesme për të gjitha vitet përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore në masën 50 %.

- b. Nota mesatare e gruplëndëve bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët), të përzgjedhura nga njësitet kryesore (fakultetet) për çdo program studimi të ciklit të parë në masën 50 % (sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.)
2. Të miratojë kriteret e pranimi për studentët në programet e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” për vitin akademik 2022-2023 (sipas shtojcës 2) , si mëposhtë:
- a. Nota mesatare e studimeve të ciklit të parë të jetë ≥ 7 (shtatë)
3. Të miratojë kuotat e pranimi për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programeve me karakter profesional 2 – vjeçar, programeve të ciklit të dytë “Master” , “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” dhe programeve të ciklit të tretë të studimeve “ Doktoraturë në Albanologji ”, për vitin akademik 2021 – 2022 sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof. dr. Bektaf MEHA

